



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 786 Prot.

Tiranë, më 14.7.2016

REKOMANDIM

Nr. 16 datë 14.7.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetime administrative në disa prej institucioneve publike dhe private të kujdesit shëndetësor, në formën ligjore të aktivitetit të tyre persona juridikë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të urdhërave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, grupet e inspektimit ushtruan procedurat e hetimit administrativ, pranë kontrolluesve publikë dhe privatë, klinika, spitale, apo laboratore, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve, (institucione të kujdesit shëndetësor) i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Kontrolluesit publikë dhe privatë, klinika, spitale, laboratore, në raport me ligjin për mbrojtjen e të dhënave janë kontrollues, të cilët mbledhin, ruajnë dhe përpunojnë një gamë të gjerë të dhënash personale, duke filluar nga ato të dhëna që në dukje janë të thjeshta, si gjeneralitetet e pacientëve, adresa apo numra telefoni e deri te ato sensitivet, si llojet e sëmundjeve dhe terapitë e ndjekura në kurimin e tyre, përhapja e të cilave shpesh ka pasoja të rënda për qytetarin pacient.

Shmangia e keqpërdorimit të të dhënave personale të individëve, qoftë dhe nga mosnjohja e ligjit, e qëllimshme apo jo, prej punonjësve të cilët aksesojnë këto të dhëna gjatë ushtrimit të detyrës në sektorin e shëndetësisë, është një detyrë e rëndësishme, që duhet zbatuar me rigorozitet nga çdo kontrollues, shtetëror apo privat qoftë ai.

U zhvilluan procedura hetimore administrative në 38 subjekte private dhe shtetërore. Subjektet e kontrolluara janë:

Blue Medical Center, IKEDA, Glob Diagnostic Center, KEIT, Klinika Bylykbashi, Klinika D'Avinci, Klinika ADC, Matric Medical Center, Klinika Italiane SantAntonio, Qendra Diagnostike Medicare, Spitali Salus, Klinika KAJO, Spitali Gjerman - Cardio Diagnostic

Hamburg Tirana, Laboratori Genius shpk, Klinika Dermo Life, Intermedica Center, Klinika Ortodokse, Spitali Hygeia, Klinika Pro Life, Spitali "Shefqet Ndroqi", Q.S.U. "Nënë Tereza", Shëndeti Mendor nr. 1, Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, Spitali i Traumës, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Spitali Obstetrik "Koco Gliozheni", Spitali Obstetrik "Nëna Mbretëreshë Geraldinë", Spitali Rajonal Fier, Spitali Rajonal Vlorë, Spitali Rajonal Durrës, Spitali Rajonal Elbasan, Spitali Rajonal Lezhë, Spitali Rajonal Shkodër, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Spitali Rajonal Sarandë, Spitali Pogradec dhe Spitali Rajonal Korçë.

Procedurat hetimore administrative, janë kryer në ambientet e kontrolluesve, ku në të gjitha rastet, nga ana e grupit të kontrollit, është marë takim me drejtuesin e institucionit, personelin ndihmës apo personat e ngarkuar për këtë qëllim, janë mbajtur në vend akt-konstatimet e nevojshme si dhe është nënshkruar në çdo rast proces-verbali i hetimit administrativ, një kopje e të cilit i është dhënë subjektit të kontrolluar.

Nga këto hetime administrative, u konstatuan një sërë shkeljesh dhe mangësish, problematikat e të cilave po i rendisim si më poshtë vijon:

Institucionet e kujdesit shëndetësor, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, janë kontrollues. Këta kontrollues, pothuajse në të gjitha rastet në kontratat me punonjësit e kujdesit shëndetësor, që aksesojnë të dhëna personale sensitive, nga ushtrimi detyrës në fushën e shëndetësisë, nuk kishin parashikuar detyrimet që ka punëmarrësi në kuptim të ruajtjes së konfidencialitetit.

Deklarata e Konfidencialitetit, e parashikuar në aktin nënligjor të Komisionerit, Vendimi Nr. 6, datë 05.08.2013, që i bashkëngjitet çdo kontrate pune është një akt parandalues për çdo rast të keqpërdorimit të të dhënave personale të subjekteve/pacientë, në shumë raste si pasojë e mosnjohjes të ligjit. (neni 28 i ligjit).

Institucionet e kujdesit shëndetësor, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre krijojnë marrëdhënie kontraktuale me subjekte juridikë që aksesojnë të dhëna personale e sensitive nga data base-t e institucioneve shëndetësore, kur kryejnë detyrimet kontraktore.

Në asnjë rast, nuk është konstatuar parashikimi i ruajtjes së konfidencialitetit, si një detyrim ligjor për palën e tretë, (neni 20 i ligjit). Aneks kontrata tip, sipas Udhëzimit Nr. 19, datë 03.08.2012, akt ky nënligjor i Komisionerit, detyrimisht është pjesë e kontratës në këto lloj marrëveshjesh kontraktuale, për parandalimin e keqpërdorimit të të dhënave personale nga të tretët. Nocioni "palë e tretë" është i një rëndësie të madhe për veprimtarinë e kontrolluesve, veçanërisht në fushën e shëndetësisë, pasi përhapja e të dhënave personale tek palët e treta kërkon detyrime të shumta, të tilla si, ekzistenca e një baze të vlefshme ligjore ose detyrimi për të mbrojtur të dhënat kundër aksesit nga një palë e tretë.

Në shumicën e rasteve, institucionet shëndetësore nuk dispononin rregullore të mbrojtjes së të dhënave personale, madje nuk kishin të parashikuar asnjë klauzolë në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit, (neni 27 i ligjit), në rregulloret e brendshme funksionale të tyre.

Në disa institucione spitalore, nuk kishte dijeni për Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe për pasojë nuk kishin përmbushur detyrimin fillestar për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, (neni 21 dhe 22 i ligjit).

Kartotekat e disa prej këtyre institucioneve, apo arkiva e kartelave klinike ishin të ekspozuara nga individët apo dhe të rrezikuara nga kushtet jo normale ku ato ishin depozituar, (neni 27 i ligjit).

Zyra e Komisionerit konstaton se, ka mungesë informacioni nga ana e institucioneve të kujdesit shëndetësor e për pasojë dhe e punëmarrësve të këtyre institucioneve.

Do të ishte në dobi të palëve, kontrollues, subjekt i të dhënave dhe përpunues, të kryeshin trajnime periodike mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, konform nenit 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*", ka realizuar seanca dëgjimore në lidhje me të drejtën e palëve për tu dëgjuar, ku kontrolluesit më së shumti shprehën gatishmërinë për të rikuperuar gjetjet e konstatuara nga grupet e inspektimit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, pasi ndoqi me vëmendje ecurinë e procedurës së hetimeve administrative dhe pretendimet e përfaqësuesve të institucioneve të shëndetësisë të shprehura në seancat dëgjimore, konkludoi nëpërmjet akteve të vendim marrjes se Komisionerit, për të cilat, në çdo rast ju kemi vënë në dijeni.

Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që kontrolluesit e kujdesit shëndetësor, gjatë kontrolleve nga grupet e hetimit administrativ kanë qenë bashkëpunues dhe reagues në lidhje me zbatimin e Ligjit "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e kujdesit shëndetësor,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, me tagrin e institucionit epror, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar detyrimin e informimit të subjekteve të të dhënave, në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe privat.
2. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar detyrimin e njoftimit dhe përditësimit të saj, për të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe privat.
3. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi*", të marrë masat në hartimin e aneks kontratave, sipas standardeve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve - pacientë, për të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe privat.

4. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat në sistemimin dhe arkivimin sipas kushteve normale të kartelave klinike, të cilat mbartin të dhëna jetike për qytetarët.
5. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar Deklaratat e Konfidencialitetit, për të gjithë punonjësit e kujdesit shëndetësor të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës në institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe privat.
6. Kontrolluesi Ministria e Shëndetësisë, duhet ti realizojë detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, brenda një afati kohor prej 6 muajve, nga dalja e këtij akti.
7. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.7.2016

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI

